



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:005658
Datë: 09.08.2024
Numri i dokumentit: 06037468

C.nr.198/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështje juridike kontestimore të paditësit M.Th. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson M.B. avokate nga Deçani, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar, vlera e kontestit 1,000.00 euro, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës, me datë 09.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit M.Th. nga Prizreni, me numër **C.nr.198/2024**, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate paditësi M.Th. nga Prizreni, përmes të autorizuarës së tij M.B. avokate, me datën 04.01.2024, ka parashtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar, vlera e kontestit 1,000.00 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë konstatoi faktin se paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore për padinë e parashtruar.

Pas kësaj gjykata me aktvendimin me shenjë C.nr.198/2024, të datës 15.07.2024, e ka ftuar paditësin që në afat prej tre (3) ditësh, të paguaj taksën gjyqësore në shumë prej 20.00 euro, si dhe e ka paralajmëruar për pasojat ligjore të mos veprimit sipas dispozitivit të këtij aktvendimi.

E autorizuar e paditësit të njëjtin aktvendim e ka pranuar më datë 19.07.2024, i cili fakt vërtetohet në bazë të fletëkthesës për dorëzim personal, e cila gjendet në shkresat e kësaj lënde dhe edhe pse ka kaluar ky afat i dhënë nga gjykata pala paditëse nuk ka ndërmarrë veprimin që ka qenë e detyruar sipas atij aktvendimi, përkatësisht gjykatës nuk ia ka dorëzuar vërtetimin mbi pagesën e taksës gjyqësore.

Andaj bazuar në të lartcekurat, si dhe duke u bazuar në nenin 102 par. 3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK), në të cilin është paraparë se: *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë.”*, e lidhur me nenin 253.5 të LPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”*, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësja nuk e ka paguar taksën gjyqësore për padinë e parashtruar, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e duke u bazuar në nenin 102 par.3 lidhur me nenin 253 par. të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.198/2024, datë 09.08.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.